



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010 dhe të dispozitave të nenit 4 të Rregullores 01. nr. 110-1201, të dt. 16.6.2010 për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 6.05.2016, merr këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR UDHËHEQJEN DHE KOORDINIMIN E
PUNËS NË TERREN PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE,
VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE

I. Emërohet Komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për territorin e komunës së Prishtinës, në këtë përbërje:

1. **Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, kryesues,
2. **Shefki Gashi** (LDK), anëtar,
3. **Qëndron Kastrati** (LVV), anëtar,
4. **Muhamet Selmani** (PDK), anëtar,
5. **Fadil Leci**, Sektori i BL, anëtar,
6. **Cuneyd Ustaibo**, (KDTP), anëtar,
7. **Luljeta Selimi**, Sektori i Kuvendit, anëtare.

II. Komisioni nga pika I e këtij vendimi, obligohet t’i raportojë Kuvendit të Komunës për rrjedhën në tubimet për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, pasi të ketë përfunduar aktiviteti zgjedhor në terren.

III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Administratës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 038-112159 , më 11.05.2016

